



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

PROJEKT-VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË DATËN 02.11.2024 NËBANESËN E Z. TAULLA ZAIMI, LAGJA "2 DHJETORI" ÇOROVODË NJ. A. ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.86 datë 21.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit të vitit 2023, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj", Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON :

- 1- Të akordojë ndihmën financiare prej 268.925 (dyqind gjashtë dhjet e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekë, familjes së z. Taulla Zaimi për dëmet e shkaktuara nga zjarri i rënë , në banesën e tij në lagjen "2 Dhjetori" Çorovodë, Njësia Administrative Çorovodë, Bashkia Skrapar .
- 2- Efektet financiare do të përballohen nga fondi i emergjencave civile, parashikuar në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Skrapar.

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FATKEQËSINË E RËNIES SË ZJARRIT NË BANESËN E Z. TAULLA ZAIMI , LAGJA " 2DHJETORI"ÇOROVODË NJËSIA ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR .

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Skrapar,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, me propozim edhe të Kryetarit të Bashkisë, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak :

- Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare nga fondi i Emergjencave Civile , në masën 268.925 (dyqind e gjashtë dhjet e tetë mijë e nëntë qind e njëzet e pesë) lekë sipas preventivit të vlerësimit të banesës së djegur nga zjarri i datës 02.11.2024, shpërblimi financiar është i pjesshëm

Sipas raportit të ndërhyrjes nga sektori i M.Z.SH Skrapar, objekti shtëpi banimi apartament me hapësirë 2 + 1 pallati 5 katësh Lagja " 2 Dhjetori" Çorovodë , është përfshirë nga flakët në mënyrë të papritur, rreth orës 19:00 të datës 02.11.2024 .Sipas proces-verbalit të mbajtur më datën 13.11.2024 në banesën e z Taulla Zaimi , Lagja " 2 Dhjetori" Çorovodë Njësia Administrative Çorovodë , Grupi i punës ka konstatuar dëme të mëdha dhe një djegje totale të banesës, të cilat janë të detajuara në proces-verbalin e sipërpërmendur .

Familja e Z.Taulla Zaimi ka nevojë për ndihmë financiare për ristrukturimin e shtëpisë . Sepse ndërtesa (banesa) në gjendjen e krijuar pas rënies së zjarrit, është bërë pjesërisht e pa banueshme .

**KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK MEMA**

